

Koha ka nisur t'i rrallojë, e prapëseprapë ende s'mund të thuhet se në Ferrara janë të paktë ata që e kujtojnë doktor Fadigatin (me siguri e kujtojnë si Athos Fadigati – otorinolaringologu që e kishte studion në shtëpinë e tij në *via Gorgadello*, dy hapa larg nga *piazza delle Erbe*, e që përfundoi aq ligisht, i gjori burrë, kaq tragjikisht, pikërisht ai që në të ritë e vet kur erdh e u vendos në qytetin tonë nga vendlindja e tij Venecia, na kish lënë përshtypjen se ish e shkruar të kishte një ndër karrierat më të rregullta, më të qeta, e pikërisht për këto arsye, më për t'u pasur zili...).

Qe në 1919-ën, menjëherë pas luftës tjetër. Për çështje moshe, unë që po shkruaj, s'mund të ofroj veçse një tablo disi të vagullt e të turbullt të asaj periudhe. Kafenetë e qendrës së qytetit zienin nga oficerët me uniformë; çdo çast përgjatë *corso Giovecca* dhe *corso Roma* (sot e ripagëzuar si *corso Martiri della Liberta*) kalonin kamionë që valëvisnin flamuj të kuq; mbi skelat që mbulonin ballinën e *Palazzo delle Assicurazioni Generali* (atë kohë në rikonstruksion), kundruall pjesës veriore të Kështjellës, qe nderë një pëlhurë gjigante reklame në ngjyrë të purpurt, që ftonte miq e kundërshtarë të socializmit të vinin të pinin bashkërisht APERITIVIN LENIN; pothuajse çdo ditë shpërthenin përleshje mes fshatarëve dhe punëtorëve ekstremistë nga njëra anë, dhe ish luftëtarëve nga ana tjetër... Kjo klimë e ethshme, trazirash politike e shpërqendrimi të përgjithshëm, nëpër të cilën kaloi fëmijëria e tërë atyre që do burrëroheshin gjatë njëzetvjeçarit të ardhshëm, në një farë mënyre duhet ta ketë favorizuar venecianin Fadigati. Në një qytet si i yni, ku pas luftës, të rinjtë e familjeve të mira nguronin më shumë se në çdo vend tjetër t'u ktheheshin profesioneve të lira, është e lehtë të kuptosh se si ai arriti të hidhte rrënjë thujse pa rënë fare në sy. Fakt është që në 1925-ën, kur edhe tek ne pasionet kishin nisur të fashiteshin, dhe fashizmi, që po organizohej në një parti të madhe kombëtare, tashmë qe në gjendje t'u ofronte ofiqe me leverdi të gjithë atyre që ende nguronin, Athos Fadigati tanimë qe sistemuar më së miri në Ferrara si titullari i një klinike të mrekullueshme private, e për më tepër, qe dhe drejtor i repartit të veshëve e gojës në spitalin e ri *Arcispedale Sant'Anna*. I kishte prirë fati, sikundër thuhet. Jo më fort i ri në moshë, dhe me pamjen, qysh atëkohë, sikur të mos kish qenë kurrë i tillë, qe i kënaqur që qe larguar nga Venecia (e rrëfeu vetë këtë një herë) jo aq për të kërkuar fatin në një qytet që s'ish i tiji, sesa për t'i shpëtuar atmosferës mbytëse të një alamet shtëpie mbi *Grand Canal* në të cilën kish parë t'i shuheshin brenda pak vitesh që të dy prindërit si dhe një motër që e kish dashur sa s'thuhet. I kish bërë për vete njerëzit me sjelljen e tij të njerëzishme, të rezervuar, me moskokëçarjen që dukej sheshit, e atë frymën e arsyeshme të bamirësisë që tregonte ndaj të sëmurëve më të varfër. Por, edhe më shumë se sa për të gjitha këto arsye, ai vlerësohej për atë që ishte: për ato gjyzlykë me skelet ari që i përshkënditnin aq lezetshëm mbi faqet e shogëta, të lëmuara, ngjyrë dheu, për atë dhjamjen aspak të pakëndshme të atij trupit të vet të bëshëm si prej një njeriu të lindur me një problem në zemër, që i kish shpëtuar për mrekulli krizës së pubertetit dhe që qe kurdoherë i mbështjellë, edhe gjatë beharit, me lesh të butë anglez (gjatë luftës, për shkak të shëndetit, kish mundur ta kryente shërbimin ushtarak tek zyra e censurës postale). Me një fjalë, ai kishte diçka që menjëherë i bëri të tjerët për vete dhe u hoqi dyshimet.

Studio e *via Gorgadello*, në të cilën ai priste pacientët çdo pasdite, nga ora katër deri në shtatë, e vulosi më pas suksesin e tij.

Bëhej fjalë për një klinikë mjaft moderne, të atillë siç nuk e kishte pasur deri atëherë asnjë doktor në Ferrara. E pajisur me një kabinet mjekësor të përkryer që, për sa i takonte pastërtisë, efikasitetit, madje edhe madhësisë, mund të krahasohej vetëm me atë të spitalit *Sant'Anna*, hijeshohej veç këtyre edhe me tetë dhoma të

apartamentit privat aty puqur, ashtu sikundër edhe me po aq salla të vogla pritjeje për vizitorët. Bashkëqytetarët tanë, veçanërisht ata më të rëndësishmit nga pikëpamja shoqërore, mbetën pa mend. Të shndërruar papritmas në njerëz që s'pajtoheshin më me atë rrëmujën piktoreske, nëse doni ta quajmë kështu, por tejet familjare e fundja të dyshimtë, me të cilën tre apo katër specialistë të moshuar lokalë vazhdonin të prisnin klientët e tyre, u ngashëryen si t'u qe bërë një nderim i veçantë. Tek Fadigati – s'lodheshin kurrë së përsërituri ata – s'iu duhej të rrinin të prisnin pafund të rrasur cip mbi cip si bagëtia, ndërkohë që mes mureve të hollë dëgjoheshin që larg zërat e ca familjeve thuajse kurdoherë gazmore e të mëdha në numër, teksa në dritën e zbehtë të ndonjë lllambe njëzet qirinjsh syri s'të zinte gjë tjetër në muret e gjatë e të trishtë veç ndonjë pllakë majolike me mbishkrimin MOS PËSHTYNI!, apo ndonjë karikaturë të ndonjë profesori universitar apo ndonjë kolegu, për të mos folur pastaj për ato pamjet edhe më të shpifura me pacientë që po iu bënë klizma të tmerrshme përballë një shkollë të tërë mjekësore, apo me laparotomi të kryera prej Vdekjes dora vetë, që ngërdheshej, e veshur si ndonjë kirurg? Si kish mundësi që patën duruar deri atëherë një trajtim të tillë si në Mesjetë?

Shumë shpejt, vajtja tek Fadigati u shndërrua në më tepër se sa një modë, në një kënaqësi të vërtetë. Veçanërisht mbrëmjeve dimërore, kur era e acartë përshkonte me frushullimë nga *piazza Cattedrale* deri poshtë *via Gorgadello*, për borgjezët e kamur u kthye në një kënaqësi e vërtetë që, duke nxjerë si pretekst edhe dhembjen më të vogël të fytit, mbështjellë me ato palltot me jakë gëzofi, të merrnin udhën për të hyrë në portëzën gjysmë të mbyllur, të ngjisinin dy palë shkallë dhe t'i binin ziles së derës së xhamtë. Aty sipër, matanë asaj kornize magjike të shndritshme, në hyrje të së cilës gjendej një infermiere me uniformë të bardhë, gjithherë e re në moshë dhe gjithherë buzagaz, aty sipër, ai gjente radiatorë që punonin me tërë fuqinë e jo si në shtëpinë e tij, po as si tek Klubi i Tregtarëve apo ai i Bashkimit. Gjente kolltukë dhe divane me bollëk, tryeza të vogla kurdoherë të pajisura me gazetatat e ditës, *abat-jours* nga të cilët përhapej një dritë e bardhë, e fortë dhe bujare. Gjente tapetë që, pasi të qesh lodhur së ndejturi aty, duke u kotur ngrohtë-ngrohtë ose duke shfletuar ndonjë revistë të ilustruar, të ngjallnin dëshirën për të kaluar nga njëri sallon tek tjetri duke parë pikturat dhe gravurat, të kahershme dhe moderne, të ngjitura ngucur-ngucur nëpër mure. Gjente pastaj një mjek të sjellshëm dhe të muhabetit që ndërsa dilte ta ftonte personalisht të shkonin “këtej” për t'i ekzaminuar fytin, dukej para së gjithash paduruar, si një zotëri i vërtetë që ishte, të merrte vesh nëse klienti i tij kish pasur mundësi të dëgjonte disa net të shkuara, në *Teatro Comunale* të Bolonjës, Aureliano Pertilen tek *Lohengrin*; ose, kë të përmendim?, nëse e kish vërejtur mirë, varur në aksh mur të aksh salloni, atë tipin De Kirikon ose atë tjetrin “*Casoratio*”, dhe nëse i kish pëlqyer ai tjetri, De Pisis; e mandej shprehte habinë e tij të thellë nëse klienti, i përgjigjej duke i pohuar se jo vetëm që s'e njihte De Pisisin, por s'e kish pasur kurrë haberin deri atë hop se Filipo De Pisis na qënkesht një piktor i ri dhe shumë premtues ferrarez. Një ambient komod, i këndshëm, luksoz, e madje tek e fundit, stimulues për trurin. Ku koha, e mallkuara kohë, që gjithmonë e gjithkund ka qenë problemi i madh i provincës, kalonte me kënaqësi.